

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER JULIAN ZHELEGU



DATE 28/12/2022
NR REP 12158

VËRTETIM NJËSIE ME ORIGJINALIN

Sot, më datë 28/12/2022, para meje Noterit JULIAN ZHELEGU, Anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2, u paraqit personalisht:

KËRKUES/IT:

Zhaneta Bedaj, atësia Abas, amësia Xhevrije, shtetase Shqiptare, lindur në Elbasan dhe banues në TIRANË, me adresë Nikolla Jorga; Nd. 9; H. 4; Ap. 27; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 01/05/1977, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033866449 dhe nr. personal H75501236Q,

e cila me kerkoi te vertetoj dokumentin e njejte me origjinalin: *Kontrate shitje aksionesh me dt. 04.03.2022 me pale Z. Fuad Haxhiymeri dhe shoqeria "PE-VLA-KU shpk.*

Unë Noteri, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezulton se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noterit, është e njëjtë me dokumentin origjinal.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
JULIAN ZHELEGU



Fq

KONTRATË SHITJE AKSIONESH

Sot më datë 04/03/2022, në Tiranë, palët e mëposhtme vendosën të lidhin kontratën e shitjes së aksioneve si më poshtë :

SHITËSI: Z. Fuad HAXHIYMERI, i lindur më 28.01.1964, ne Tirane, shtetas Shqiptar, me adrese Rruga Lek Dukagjini, Nr. 11, 01101, Tirane, mbajtes i letërnjoftimit me nr. 033687416 dhe numer personal: G40128172R, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar *[në cilësinë e Shitësit]*,

Dhe

BLERËS: Shoqeria "PE-VLA-KU" sh.p.k., person juridik i së drejtes shqiptare, me NIPT K61716013M, me seli në adresen Njesia Bashkiake Nr. 9, Rruga Muzaket, Pallatet Vokshi, Hyrja 1, Kati 7, Tirane, perfaqesuar nga administratori **Z. Vladimir Pjetërgjokaj**, i datelindjes 16.05.1972, identifikuar me letërnjoftimin ID 033265951 dhe me numër personal H20516169B, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar *[në cilësinë e Blerësit]*.

OBJEKTI: Shitja e 2,869,860 (dy milion e teteqind e gjashtedhjetë e nente e teteqind e gjashtedhjetë) aksioneve të "BANKA CREDINS" sh.a, që zotërohen nga aksionari **Z. Fuad HAXHIYMERI** dhe blerja e tyre nga shoqeria "PE-VLA-KU" sh.p.k.

PËRMBAJTJA E KONTRATËS

Shoqëria "BANKA CREDINS" SH.A., është një shoqëri anonime e krijuar e që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë, Nr. 28969, datë 31.01.2003, e regjistruar në Organet Tatimore me Kodin Fiskal Nr. 3709529, NIPT K316088010 si dhe me licencën Nr.16, datë 31.03.2003 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.



ÇMIMI I SHITJES SË AKSIONEVE DHE MËNYRA E PAGESËS.

Palët kanë rënë dakord që 2,869,860 (dy milion e teteqind e gjashtedhjetë e nente e teteqind e gjashtedhjetë) aksione të shiten me çmimin 4,930,000 Euro (kater milion e nenteqind e tridhjetë mijë).

Pagesa në shumën e mësipërme do të kryhet në rrugë bankare dhe do të derdhet në llogarinë e Shitësit pranë Bankës Credins me nënshkrimin e kontratës.

MENYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE

Shitësi është plotësisht dakord dhe i shet me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë Blerësit 2,869,860 (dy milion e teteqind e gjashtedhjetë e nente e teteqind e gjashtedhjetë) aksione të shoqërisë "BANKA CREDINS" SH.A., pjesë e paketës së aksioneve të tij, që ai zotëron në kapitalin aksionar të Bankës.

Nga ana e tij, Blerësi, shoqëria "PE-VLA-KU" sh.p.k., është plotësisht dakord të blejë 2,869,860 (dy milion e teteqind e gjashtedhjetë e nente e teteqind e gjashtedhjetë) aksione të shoqërisë "BANKA CREDINS" SH.A, të zotëruara nga shitësi në kapitalin aksionar të Bankës.

Kalimi i pronësisë do të bëhet me pagesën e plotë të shumës 4,930,000 Euro (kater milion e nenteqind e tridhjetë mijë) nga ana e Blerësit shoqëria "PE-VLA-KU" sh.p.k. në llogarinë e Shitësit Z. Fuad HAXHIYMERI.

KLAUZOLAT PER TE DREJTAT MBI DIVIDENTIN DHE TE TJERA

Aksionet objekt kontrate kalojnë dhe transferohen tek Blerësi së bashku me të gjitha të drejtat që shoqërojnë dhe lidhen me aksionet, përfshirë çdo lloj dividendi, rritje kapitali, e drejta e votes, dhe në përgjithësi çdo lloj e drejte tjetër e përmendur, por që njihet nga statuti dhe ligji. Përfitimi i këtyre të drejtave bëhet së bashku me transferimin e pronësisë mbi aksionet nga Shitësi tek Blerësi me pagesën e çmimit të shitjes së aksioneve.



LIGJI I ZBATUESHEM



Palët bien dakord që kjo Kontratë do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për çfarë nuk parashikohet në këtë Kontratë aplikohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë mbi shitjen.

TË TJERA

Kontrata hartohet në 4 kopje origjinale, duke patur të gjitha vlerë të njëjtë, nënshkruhet prej palëve me dëshirë dhe vullnetin e tyre të plotë e të pavesuar.

SHITËS

Z. Fuad HAXHIYMERI

BLERËS

Shoqëria "PE-VLA-KU" sh.p.k.

Vladimir Pjetërgjokaj

